

BRIKENA LIKO

**MARRËDHËNIET KRAHASORE NË PERIUDHË
NË KËNDVËSHTRIMIN GJENERATIV**

Hyrje

Ky artikull është bazuar në studimet e mëparshme mbi gjuhën shqipe dhe ato gjenerative të huaja mbi ndërtimet krahasore në gjuhë të veçanta, por edhe mbi tiparet universale të këtyre ndërtimeve. Duke pasur këto për bazë, do të bëhet një paraqitje e qëndrimeve kryesore të ilustruara me shembuj nga gjuha shqipe. Konkretisht do të shihet shkurtimisht dukuria e fshirjes në ndërtimet krahasore, dukuria e lëvizjes, hipoteza nëse disa raste të fjalive krahasore paraqesin marrëdhënie bashkërenditëse dhe funksioni i tyre në përbërje të periudhës.

Fjali e varur krahasore është quajtur ajo periudhë në të cilën veprimi a gjendja për të cilën bëhet fjalë në fjalinë drejtuese karakterizohet me anë të një krahasimi me një veprim a gjendje të shprehur në fjalinë e varur.¹ Përbërësi i krahasuar që ndodhet në fjalinë drejtuese, quhet *gjymtyra e parë e krahasimit*, ndërsa fjalia krahasore përmban ose përbën ajo vetë *gjymtyrën e dytë të krahasimit*.²

P.sh. Aq sa do të rrojë fasulja në këtë mur, po aq rroftë edhe në poçen tënde, o mjeshtër! (Z. Çela, Arkipelagu Spiritus.)

Në këtë periudhë, objekti i krahasimit është kohëzgjatja e asaj çfarë shpreh kallëzuesi i fjalisë drejtuese me atë të fjalisë së varur. Pra kemi marrëdhënie krahasore të barazisë kohore midis fjalisë drejtuese dhe fjalisë së varur.

Midis dy anëve të krahasimit krijohet një kontrast i pjesshëm ose i shumëfishtë i lidhur me ndryshoret e krahasimit, pasi pa kontrast nuk do të kishte krahasim. Ka ndërtime krahasore me një, dy, tri ose katër ndryshore, por ka edhe raste kur kontrasti krijohet vetëm me ndryshimin e nuancës kuptimore të të njëjtit element të gjendur në të dyja pjesët e krahasimit, pra kontrasti mund të prekë qoftë edhe pjesërisht një element të fjalisë. P.sh., foljet mund të jenë të njëjta nga ana leksikore dhe të ndryshojë vetëm koha ose folja modale.³

- ...më tepër u mundua të blinte, sesa të shiste.

(një ndryshore: blinte - shiste)

- “Bejlerët kanë një zakon të rrënjosur, më parë therin djalin, sesa hanë fjalën e dhënë.” (Z. Çela, Apokalipsi sipas Shën Tiranës)

¹ ASHSHSH, *Gramatika e gjuhës shqipe, vëllimi II, Sintaksa*, Tiranë, f. 605.

² A. Belletti (1991), *Le frasi comparative*, in *Grande grammatica italiana di consultazione*, a cura di L. Renzi, G. Salvi & A. Cardinaletti, Bologna, il Mulino, 1988-1995, 3 voll., vol. 2° (I sintagmi verbale, aggettivale, avverbiale. La subordinazione), f. 833.

³ R. Quirk, S. Greenbaum, G. Leech, and J. Svartvik (1985), *A Comprehensive Grammar of the English Language*, Longman, London, f. 1133.

Në këtë ndërtim krahasor kemi 2 ndryshore: therin – hanë / djalin – fjalën e dhënë.

• *Po aq sa jeta e tij varej atëherë prej teje, tani varet e jotja prej tij.* – (Zija Çela, *Arkipelagu Spiritus*)

Në këtë ndërtim kemi 3 ndryshore: jeta e tij – jotja / atëherë – tani / prej teje – prej tij.

Disa përjasje gjenerative mbi ndërtimet krahasore:

Si fillim duhet thënë, se vështirësia e gjetjes së universaleve në ndërtimet krahasore rritet po të kemi parasysh heterogjenitetin e këtyre ndërtimeve.

Po të shohim strukturën e jashtme të fjalive krahasore, do të vëmë re se i gjithë ndërtimi është si një përbërës i vetëm që emërtohet sipas kokës përkatëse.⁴

Fshirja në ndërtimet krahasore

Fshirja në ndërtimet krahasore është një term i prezantuar nga Bresnan (1973, 1975) për të përshkruar ato ndërtime në të cilat një përbërës mbiemëror, ndajfoljor ose emëror fshihet nga paraqitja sipërfaqësore e fjalive krahasore. Si fillim, duke përdorur fjalët e Keneddy-t (2002)⁵ duhet të sqarojmë se elipsa duhet të shqyrtohet si paraqitje fonetike e fshirjes së materialit sintaksor, pra është e njëjta dukuri e parë nga dy pikëpamje të ndryshme.

Në këto lloj ndërtimesh krahasohen dy sasi të të njëjtit lloj. Konkretisht, sipas këtij përcaktimi, në rastet kur në strukturën e thellë përmasa që krahasohet është e njëjtë në të dyja pjesët e krahasimit, atëherë në njërin prej tyre ndodh dukuria e fshirjes. Prandaj në pjesën e dytë të krahasimit ai element nuk shfaqet. Ndërsa në rastet kur përmasa që krahasohet është e ndryshme, atëherë përsëritja është e detyrueshme dhe nuk kemi fshirje të atij elementi.

Shohim shembujt më poshtë:

Më shumë dëgjohej radioja, sesa shihej televizori. (Sos, një buzëqeshje, Zija Çela)

Në këtë fjali kemi dy ndryshore: dëgjohej – shihej / radioja – televizori.

Të dyja çiftet e ndryshoreve duhet të jenë të pranishme. Në rast se një nga këto çifte do të kishte shenjën e barazimit, atëherë njëri prej tyre nuk do të përsëritej, rrjedhimisht do të kishim dukurinë e fshirjes.

Më shumë dëgjohej radioja, sesa ~~dëgjohej~~ televizori.

Më shumë dëgjohej televizori, sesa shihej ~~televizori~~.

“Bejlerët kanë një zakon të rrënjosur, më parë therin djalin, sesa hanë fjalën e dhënë.” (Z. Çela, Apokalipsi sipas Shën Tiranës)

Pra, në ato raste kur nuk kemi elemente të njëjta në të dyja anët e krahasimit, nuk mund kemi fshirje.

⁴ B. Santorini, *Annotation manual for the Penn Historical Corpora and the PCEEC*, Release 2 (January 2010), University of Pennsylvania, School of Arts, <http://www.ling.upenn.edu/histcorpora/annotation/>

⁵ C. Kennedy, *Comparative Deletion and Optimality in Syntax* (Natural Language & Linguistic Theory, Vol. 20, No. 3 (Aug., 2002), pp. 553-621), Published by: Springer
Stable URL: <http://www.jstor.org/stable/4048056>

Marrëdhëniet krahasore në periudhë në këndvështrimin gjenerativ

Në *Grande grammatica italiana di consultazione*⁶ për sa i përket fshirjes apo elipsës thuhet se elipsat e foljeve janë të mundura vetëm në periudhat me fjali krahasore të barazisë, jo në ato të pabarazisë. Përndryshe do të krijoheshin fjali jogramatikore. Nga shembujt e marrë në shqyrtim mund të thuhet se kjo nuk vlen gjithmonë për gjuhën shqipe, përkundrazi.

P.sh. Fjalja e mëposhtme është një fjali krahasore barazie në të cilën kallëzuesi me të njëjtën folje përsëritet, por po të hiqet njëri nga të dy kallëzuesit, fjalia nuk do të qëndronte.

Po aq sa jeta e tij varej atëherë prej teje, tani varet e jotja prej tij. (Z. Çela, *Arkipelagu Spiritus*)

Mirëpo kjo dukuri ndodh në një fjali krahasore të pabarazisë, ku kallëzuesi *desha* nuk përsëritet, por fjalia qëndron shumë mirë, madje përsëritja nuk duket e natyrshme.

Për të qenë i hapur me ju, e desha më shumë kur e prita, sesa kur e përcolla. (Z. Çela, Goja e botës)

Studime të tjera të viteve të fundit kanë mbrojtur mendimin se teoria e fshirjes nuk qëndron për të gjitha gjuhët, pra nuk është një dukuri universale.⁷

Teoria e lëvizjes në ndërtimet krahasore

Teoria e lëvizjes është propozuar fillimisht nga Chomsky (1977)⁸ sipas të cilit në fjalitë krahasore, gjatë kalimit nga struktura e thellë në atë sipërfaqësore shfaqet dukuria e lëvizjes së një elementi cilësues në pozicionin fillestar të frazës.

Për sa i përket mendimit se fjalitë krahasore gjenerohen në strukturën e thellë në të njëjtin pozicion që zënë në strukturën sipërfaqësore apo jo, ka pasur mendime të ndryshme.

Sipas Joan Bresnan-it (1972) fjalitë krahasore janë komplementë të determinantëve. Ajo ka argumentuar se fjalitë krahasore gjenerohen brenda determinantit dhe cilësorëve të frazës që ato modifikojnë.

Mirëpo, në kundërshtim me të, studiues të rinj të mëvonshëm, si Andrews⁹ kanë mbrojtur hipotezën se fjalitë krahasore, ashtu si ato lidhoret, nuk mund të trajtohen njësoj si llojet e tjera të fjalive, pra nuk mund të trajtohen si përbërës të strukturës së thellë me kokat e tyre, sepse, sipas tij ato janë gjeneruar larg dhe të pavarura prej kokave të veta. Gjithashtu ai ka bërë dy përjasje të ndryshme në lidhje me këtë çështje. Ai ka mbrojtur mendimin se fjalitë krahasore gjenerohen në

⁶ A. Belletti, (1991), *Le frasi comparative*, in *Grande grammatica italiana di consultazione*, a cura di L. Renzi, G. Salvi & A. Cardinaletti, Bologna, il Mulino, 1988-1995, 3 voll., vol. 2^o (I sintagmi verbale, aggettivale, avverbale. La subordinazione), f. 846.

⁷ J. Bacsikai-Atkari, University of Potsdam, *Comparative deletion in Germanic*, Comparative Germanic Syntax Workshop 28, Leipzig, 4-5 October 2013.

⁸ N. Chomsky, 1977, *On Wh-movement*, in Peter Culicover, Thomas Wasow and.

Adrian Akmajian (eds.), *Formal Syntax*, Academic Press, New York.

⁹ *Studies in the syntax of relative and comparative clauses* by Avery Delano Andrews III, B.A. Harvard University, 1971, (submitted in partial fulfillment of the requirements for the degree of doctor of philosophy):

strukturën e thellë në të njëjtin pozicion që zënë në strukturën sipërfaqësore dhe ka mbrojtur hipotezën se struktura bazë e ndërtimeve krahasore është e njëjtë si në shtresën e thellë edhe në atë sipërfaqësore.

Në një studim tjetër të vitit 2005, *The comparative construction and the Wh-movement*¹⁰ mbrohet teoria e lëvizjes dhe mendimi se ndërtimet krahasore janë universale në të gjitha gjuhët. Aty parapëlqehet teoria e lëvizjes në krahasim me atë të “fshirjes” me argumentin se teoria e lëvizjes është më e përgjithshme dhe përfshin më shumë gjuhë, ndaj nuk kërkon përshtatje për rregullat specifike të gjuhëve të ndryshme, pra është në të mirë të ekonomisë së teorive gjuhësore. Aty argumentohet se ndërtimet krahasore janë universale dhe ndryshimi i vetëm qëndron te veçoria e gjuhëve, pra te strategjia që përdorin ato gjuhë për të pasqyruar lëvizjen (duke e shfaqur apo duke e mbuluar atë). Pra, ai e ka shtrirë teorinë e lëvizjes së elementit *wh* edhe në ndërtimet krahasore duke pretenduar se në këto ndërtime kemi një lëvizje të elementit *wh* që lë një gjurmë në fjalinë e varur.

Në fjalitë krahasore mjeti lidhës është koka e sintagmës komplementuese që tërheq sintagmën sasiore. Në gjuhën shqipe mbiemri ose ndajfolja në shkallën krahasore vendoset në fjalinë drejtuese, ashtu si në anglisht dhe italisht, dhe shërben si korrelat. Mjeti lidhës krahasor vendoset në krye të fjalisë së varur krahasore.

Sidoqoftë efekti që edhe më i madh, sesa të kishte qenë prej çeliku. (Z. Çela, Arkipelagu Spiritus.)

Raporte bashkërenditëse apo nënrenditëse

Në një studim për portugalishten evropiane¹¹ të autoreve Gabriela Matos dhe Ana Brito është hedhur hipoteza se raportet krahasore janë raporte bashkërenditëse dhe jo nënrenditëse. Por mund të themi se në gjuhën shqipe kjo lidhet me natyrën e ndërvarësisë së ngushtë të fjalisë së varur me atë drejtuese. Në disa raste, për shkak të paralelizmit strukturor të ndërtimeve krahasore, ky mendim duket sikur gjen vend edhe për gjuhën shqipe. Bëhet fjalë për ato raste kur marrëdhëniet krahasore mund të jenë fjali drejtuese për përbërës sintaksorë-fjali të të njëjtit lloj për nga ana funksionale dhe të ngjashme nga ana strukturore. Të tilla raste lidhen me paralelizmin strukturor të fjalive krahasore, por të bëjnë të mendosh edhe se sa pranë marrëdhënieve bashkërenditëse janë ato, pasi fjalitë e varura prej tyre janë shumë pranë fjalive homogjene.

Por, nëse shohim rendin e përbërësve në këto lloj ndërtimesh, praninë e fjalëve korrelative në fjalinë drejtuese dhe nëse bëhet një vështrim i tipareve që dallojnë marrëdhëniet bashkërenditëse nga ato nënrenditëse (si pavarësia

¹⁰ Wei-wen Liao, *The comparative construction and the Wh-movement*, National Tsing Huan University.

¹¹ G. Matos & A. Brito, *Comparative clauses and cross linguistic variation: a syntactic approach*, Empirical Issues in Syntax and Semantics 7, O. Bonami & P. Cabredo Hofherr (eds.) 2008, pp. 307–329, <http://www.cssp.cnrs.fr/eiss7>

Marrëdhëniet krahasore në periudhë në këndvështrimin gjenerativ

kuptimore), do të shihnim se marrëdhëniet krahasore nuk i plotësojnë kushtet për t'u quajtur fjali të bashkërenditura.

P.sh. *Për të qenë i hapur me ju, e desha më shumë kur e prita, sesa kur e përçolla.* (Z. Çela, *Goja e botës*.)

Në këtë periudhë vendosen marrëdhënie krahasore midis dy fjalive të varura kohore. Fjalitë e varura kohore janë të varura në raport me fjalinë e tyre drejtuese “e desha më shumë”, dhe “e desha” në fjalinë e dytë, folje që në njërin rast ka pësuar elipsë ose fshirje.¹² Pikërisht ky është një nga ato raste që të bën të mendosh se marrëdhëniet krahasore kanë tipare bashkërenditëse dhe jo nënrenditëse. Fjalitë e varura kohore kryejnë funksionin sintaksor të rrethanorit të kohës për fjalitë e tyre drejtuese.

Mbi funksionin sintaksor të fjalive krahasore

Nga pikëpamja funksionale fjalitë krahasore nuk janë fjali argumentuese, ato nuk bëjnë pjesë tek argumentet e foljes kallëzues të fjalisë drejtuese dhe si të tilla nuk varen shumë nga natyra e kësaj foljeje. Varësia që krijojnë ato nga fjalia e tyre drejtuese është më tepër e tipit kuptimor, sesa e tipit strukturor.¹³

Fjalitë e varura krahasore nuk bëjnë pjesë as te fjalitë rrethimore. Po të zbresim në nivelin e fjalisë së thjeshtë, në gjuhësinë tonë nga pikëpamja funksionale marrëdhëniet krahasore përfaqësohen nga gjymtyra e krahasimit, e cila zë një vend të veçantë midis gjymtyrëve të tjera të dyta¹⁴. Ajo cilësohet si pjesa e dytë e një krahasimi, pra pjesa që krahason dhe mund t'i përgjigjet çdo gjymtyrë në fjali. Po të rikthehemi në nivelin e periudhës, fjalia e varur krahasore mund t'i referohet një fjalie tjetër të varur ose një gjymtyrë të fjalisë drejtuese. Një qëndrim është ai sipas të cilit funksioni i fjalisë krahasore të lidhet me paraprijësin e saj që gjendet te fjalia drejtuese. Ajo është modifikuese e paraprijësit të saj.

Përfundime

Ky ishte një vështrim i shkurtër mbi disa nga çështjet e diskutueshme mbi ndërtimet krahasore dhe disa nga qëndrimet e studiuesve që janë marrë gjerësisht me to. Mendimet janë nga më të ndryshmet mbi tiparet e fjalive krahasore që janë universale dhe mbi ato që shfaqen vetëm në disa gjuhë.

Mbi çështjet e mësipërme, mund të themi se për fjalitë krahasore në gjuhën shqipe mund të flasim për dukurinë e fshirjes dhe atë të lëvizjes, por nuk qëndron mendimi se fjalitë krahasore vendosen në raporte bashkërenditëse me fjalinë drejtuese.

¹² Në Gramatikën e gjuhës shqipe II, f. 607 thuhet: “Këto raste, shpjegohen nga një elipsë (që tashmë nuk ndihet si e tillë) e foljes drejtuese të fjalisë së dytë të varur.”

¹³ Cristina de Santis, http://www.treccani.it/enciclopedia/frasi-comparative_%28Enciclopedia_dell%27Italiano%29/

¹⁴ Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 2002, f. 283.

BIBLIOGRAFI

Libra:

- A. Belletti (1991), *Le frasi comparative*, in *Grande grammatica italiana di consultazione*, a cura di L. Renzi, G. Salvi & A. Cardinaletti, Bologna, il Mulino, 1988-1995, 3 voll., vol. 2° (I sintagmi verbale, aggettivale, avverbiale. La subordinazione), f. 832-853.
- Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002.
- R. S. Quirk, S. Greenbaum, G. Leech, and J. Svartvik (1985), *A Comprehensive Grammar of the English Language*, Longman, London.

Internet:

- Avery Delano Andrews “*Studies in the syntax of relative and comparative clauses*” by III, B.A. Harvard University, 1971.
<http://www.ai.mit.edu/projects/dm/theses/andrews75.pdf>.
- Beatrice Santorini, *Annotation manual for the Penn Historical Corpora and the PCEEC*, Release 2 (January 2010), University of Pennsylvania, School of Arts
<http://www.ling.upenn.edu/histcorpora/annotation/>
- Christopher Kennedy, *Comparative Deletion and Optimality in Syntax*, (Natural Language & Linguistic Theory, Vol. 20, No. 3 (Aug., 2002), pp. 553-621), Published by: Springer Stable URL: <http://www.jstor.org/stable/4048056> De Santis, Cristina,
http://www.treccani.it/enciclopedia/frasi-comparative_%28Enciclopedia_dell%27Italiano%29/.
- Gabriela Matos dhe Ana Brito, *Comparative clauses and cross linguistic variation: a syntactic approach*, Empirical Issues in Syntax and Semantics 7, O. Bonami & P. Cabredo Hofherr (eds.) 2008, pp. 307–329, <http://www.cssp.cnrs.fr/eiss7>
- Joan Bresnan, *Comparative Deletion and Constraints on Transformations*, *Linguistic Analysis* 1, 1975, 25–74. Dhe Joan Bresnan, *Syntax of the Comparative Clause Construction in English*, *Linguistic Inquiry* 4, 1973, 275–343. <http://www-bcf.usc.edu/~pancheva/Bresnan1973.pdf>
- Julia Bacsikai-Atkari, University of Potsdam, *Comparative deletion in Germanic*, Comparative Germanic Syntax Workshop 28, Leipzig, 4-5 October 2013, http://www.ling.uni-potsdam.de/~bacsikai-atkari/pdf/handout_cgsw28_bacsikai_atkari.pdf
- Noam Chomsky, 1977, ‘On Wh-movement’, in Peter Culicover, Thomas Wasow and Adrian Akmajian (eds.), *Formal Syntax*, Academic Press, New York, http://babel.ucsc.edu/~hank/On_WH-Movement.pdf
- Wei-wen Liao, *The comparative construction and the Wh-movement*, National Tsing Huan University
(http://ling.nthu.edu.tw/USTWPL/vol1/8_The%20Comparative%20Construction%20and%20the%20Wh-Movement_Liao,%20Wei-Wen.pdf).

Shembujt e përdorur:

- Z. Çela, *Apokalipsi sipas Shën Tiranës*, roman, Toena, Tiranë, 2011.
- Z. Çela, *Sos, një buzëqeshje*, roman, Ideart, Tiranë, 2009.
- Z. Çela, *Arkipelagu Spiritus*, roman, Toena, Tiranë, 2014.